



www.aidboxcommunity.co.uk

AidBoxConnections

Lehtësimi i izolimit, krijimi i miqësive dhe komuniteteve

Për kë është shërbimi: - njerëzit që janë shpërngulur (refugjatë dhe azilkërkues) dhe që tani jetojnë në Bristol, që dëshirojnë të takojnë një mik dhe të ndihen pjesë e një komuniteti.

Si funksionon: ne do t'ju përshtatim me një "mik të Connection-it", një person miqësor që është i familjarizuar me Bristol-in dhe ka dëshirë që të zërë një mik të ri. Ai do t'ju telefonojë dy herë në javë për bisedë në një kohë që ju përshtatet të dyve. Pas 12 javësh mund të zgjidhni që të:

1. vazhdoni miqësinë tuaj në rritje pa përfshirjen e ABC-së
2. shkëputni kontaktin
3. lidheni me dikë tjetër

Ne do të mbajmë kontakte të rregullta me ju gjatë 12 javëve dhe do të jemi në dispozicion që të kontaktoni në çdo kohë nëse keni ndonjë problem.

Miku i Connection-it është aty për miqësi dhe për zvogëlimin e ndjesive të izolimit, jo për zgjidhjen e problemeve apo dhënien e këshillave. Të gjithë miqtë tanë të Connection-it janë trajnuar për shërbimet në dispozicion në Bristol që mbështetin refugjatët dhe azilkërkuesit, në mënyrë që të mund t'ju ndihmojnë të kërkon mbështetjen për të cilën mund të keni nevojë. Gjithashtu, ata mbikëqyren nga afër në mënyrë që të garantojnë sigurinë e të gjithëve.

Të gjitha kontaktet do të jenë përmes telefonit, WhatsApp-it, thirrjes me video - ju **NUK** do të takoheni personalisht gjatë programit 12-javor.

Imogen-i dhe Naomi janë koordinatorët e Aid Box Connections-it dhe mund t'i kontaktoni nëse keni ndonjë shqetësim apo problem me këtë shërbim.

- Imogen-i 07378 663110 imogen@aidboxcommunity.co.uk
- Naomi 07378684891 naomi@aidboxcommunity.co.uk

Deklarata e privatësisë

I vetmi informacion që do të ndajmë është emri dhe numri juaj i telefonit, përveçse nëse jemi të shqetësuar për sigurinë tuaj ose të dikujt tjetër. Do të varet nga ju se çfarë informacioni tjetër dëshironi të ndani me mikun tuaj të Connection-it.